

VENDIM
Nr. 251, datë 24.4.2003

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE TË SISTEMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË KANALIZIMEVE, TË
NDËRMARRJEVE NË BULQIZË, FUSHË-ARRËZ, GRAMSH, KRASTË, KUÇOVË, MALËSI E
MADHE, MIRDITË, PESHKOPI, PËRMET, POLIÇAN, PUKË, RROGOZHINË, SKRAPAR,
SHKODËR, VAU I DEJËS DHE VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 dhe 8, pika 3 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, si më poshtë vijon:
 - a) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm, që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Bulqizë, sipas listës 1 të përbërë nga 10 (dhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - b) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve që administrohet nga sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime, Fushë-Arrëz, sipas listës 2 të përbërë nga 2 (dy) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - c) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm, që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Gramsh, sipas listës 3 të përbërë nga 14 (katërmëdhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - ç) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve që administrohet nga ndërmarrja e Ujësjiellës-Kanalizimeve, Krastë, sipas listës 4 të përbërë nga 4 (katër) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - d) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve që administrohet nga sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime, Kuçovë, sipas listës 5 të përbërë nga 10 (dhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - dh) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Malësi e Madhe, sipas listës 6 të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - e) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Mirditë, sipas listës 7 të përbërë nga 3 (tri) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - ë) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Peshkopi, sipas listës 8 të përbërë nga 10 (dhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - f) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Përmët, sipas listës 9 të përbërë nga 10 (dhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - g) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Poliçan, sipas listës 10 të përbërë nga 3 (tri) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - gj) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime, Pukë, sipas listës 1 të përbërë nga 24 (njëzet e katër) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - h) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve që administrohet nga sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime, Rrogozhinë, sipas listës 12 të përbërë nga 4 (katër) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - i) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Skrapar, sipas listës 13 të përbërë nga 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - j)) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve që administrohet nga sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime, Shkodër, sipas listës 14 të përbërë nga 7 (shtatë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - k) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga Ndërmarrja e Ujësjiellësit, Vau i Dejës, sipas listës 15 të përbërë nga 2 (dy) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - l) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Vlorë, sipas

listës 16, të përbërë nga 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave për t'u transferuar në njësitë e qeverisjes vendore, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano